REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

# V E N D I M

**Nr. 672, datë 22.11.2017**

**PËR**

**PROPOZIMIN E PROJEKTLIGJIT "PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS"**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Propozimin e projektligjit "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës", për shqyrtim e miratim në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN

PANDELI MAJKO

NR.PROT.5280/8
DATË 23.11 2017

KUVENDIT
MINISTRIT TË SHTETIT PËR DIASPORËN

**Sekretari i Përgjithshëm**

**Engjëll AGAÇI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - KËSHILLI I MINISTRAVE

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**Kuvendi**

# P R O J E K T L I GJ

## PËR

## KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE TË DIASPORËS

Në mbështetje të neneve 78, 81, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

**V E N D O S I:**

## KREU I
## DISPOZITA TË PËRGJTHSHME

### Neni 1
### Objekti

Ky ligj përcakton misionin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës, si dhe çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e saj.

### Neni 2
### Misioni

Agjencia Kombëtare e Diasporës ka për mision zhvillimin dhe thellimin e bashkëpunimit institucional me diasporën, nëpërmjet:

a) përmirësimit të pozitës së anëtarëve të diasporës, si dhe mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre në vendet ku ata jetojnë;
b) ofrimit të ndihmës për ruajtjen e trashëgimisë kulturore kombëtare;
c) nxitjes së bashkëpunimit ekonomik ndërmjet vendit të origjinës dhe diasporës;
ç) bashkëpunimit për prosperitetin e të gjithë kombit, paqen, mirëqenien, kulturën dhe solidaritetin shoqëror.

## Neni 3
## Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **"Agjencia Kombëtare e Diasporës"**, këtu e në vijim "Agjencia", është organi shtetëror përgjegjës për marrëdhëniet me diasporën.

2. **"Diaspora"** përfshin:

   a) komunitetet e hershme shqiptare në botë;
   b) çdo person i cili është lindur në Shqipëri dhe që jeton jashtë kufijve të saj;
   c) çdo person i cili ka lindur jashtë kufijve të Shqipërisë, por ka origjinë shqiptare.

3. **"Ministër përgjegjës"**, ministri që mbulon fushën e veprimtarisë shtetërore për marrëdhëniet me diasporën.

4. **"Vend i origjinës"**, Republika e Shqipërisë.

## Neni 4
## Parimet e veprimtarisë

Agjencia organizohet dhe funksionon në bazë të këtyre parimeve të përgjithshme:

a) Ligjshmërisë, kushtetutshmërisë;
b) Parimit të bashkëpunimit;
c) Parimit të gjithëpërfshirjes.

# KREU II
# ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I AGJENCISË

## Neni 5
## Organizimi i Agjencisë

1. Agjencia është person juridik publik, në formën e agjencisë autonome, me seli në Tiranë.

2. Veprimtaria e Agjencisë do të jetë nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për diasporën.

3. Organet drejtuese të Agjencisë janë Këshilli Drejtues dhe drejtori Ekzekutiv.

4. Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e Agjencisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

5. Struktura dhe organika e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit.

6. Marrëdhëniet e punës për drejtorin Ekzekutiv dhe nëpunësit e Agjencisë rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen në përputhje me dispozitat e parashikuara në Kodin e Punës.

7. Agjencia ka logon dhe vulën e saj, të miratuar nga drejtori Ekzekutiv.

**Neni 6**
**Detyrat e Agjencisë**

Agjencia kryen këto detyra:

1. Për të garantuar procesin e regjistrimit dhe të drejtën e pjesëmarrjes së diasporës në votime, bashkëpunon me institucionet e tjera shtetërore dhe harton databazën e diasporës.
2. Merr masat për krijimin e databazës unike të diasporës dhe përcakton ndërveprimin nëpërmjet bashkëpunimit me bazat e tjera shtetërore të të dhënave;
3. Krijon kushtet infrastrukturore për të garantuar të drejtën e votës për shtetasit shqiptarë në vendet ku ata jetojnë;
4. Zbaton politikat dhe projektet që lidhen me diasporën;
5. Përgatit raporte periodike, të cilat ia paraqet ministrit përgjegjës;
6. Përgatit dhe koordinon punën për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën dhe ndjek zbatimin e saj;
7. Përmirëson lidhjet ndërmjet diasporës, organizimeve të saj dhe vendit të origjinës;
8. Përgjigjet për funksionimin dhe menaxhimin financiar, si dhe kontrollon periodikisht realizimin e tij;
9. Bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me institucionet e tjera shtetërore, shoqërinë civile dhe organizatat e tjera brenda dhe jashtë vendit për përmirësimin e pozitës së anëtarëve të diasporës;
10. Ndihmon në ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kombëtare e kulturore të anëtarëve të diasporës;
11. Informon diasporën mbi proceset politike në vendin e origjinës, me qëllim përfshirjen e tyre në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të Republikës së Shqipërisë;
12. Administron asetet.